



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101258/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë.*

Drejtuar: **Z. Flamur GOLEMI**
Kryetar i Bashkisë

GJIROKASTËR

Znj. Luneda SUFALI
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Për dijëni: **Z. Aranit MUHO**
Drejtor i Shtëpisë së të Moshuarve

GJIROKASTËR

Të nderuar,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë, më datë 21.09.2021, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2021 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Ermonela Xhafa, me detyrë Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Lindita Xhillari me detyrë ndihmës komisionerë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre. Mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme

të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës fizike tej kufijve në tejkallim të standardeve.

Grupi inspektimit, gjatë vizitës kërkoi të informohet në veçanti edhe mbi masat e marra nga ana e këtij institucioni, për parandalimin e sëmundjes infektive Covid-19¹. Nga informacioni i mbledhur dhe nga këqyrja në ambientet e këtij institucioni rezultoi se është zbatuar protokollin shtesë i shëndetësisë për masat anti-Covid-19. Çdo ditë, stafit të institucionit i ushtrohet kontrolli për matjen e temperaturës para hyrjes në institucion, si dhe pajiseshin me maska dhe doreza. I gjithë personeli zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, duke pasur një vëmendje të shtuar në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, përdorimin e dezinfektantëve që ndodheshin në ambientet e përbashkëta por dhe duke ruajtur distancimin social dhe higjienën personale. Ishin minimizuar grumbullimet e stafit, mbledhjet dhe kontaktet me të tretë. Urdhrat, udhëzimet dhe protokollin shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), ishin afishuar në ambientet e institucionit. E rëndësishme është për t'u theksuar se që në fillim të pandemisë në zbatim edhe të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë, të moshuarve ju është kufizuar lëvizja jashtë institucionit, deri sa gjendja ju rikthye normalitetit. Stafit dhe të moshuarit ishin prekur nga covid-19, por fatmirësisht nuk kishte pasur humbje jete. Tashmë të gjithë ishin vaksinuar. Takimet me familjarë e të afërm lejoheshin vetëm në distancë në oborrin e institucionit dhe nën mbikëqyrjen e stafit. Pacientëve iu është mundësuar komunikimi i shpeshtë me familjarët nëpërmjet telefonit.

Ju bëjmë me dije së, nga inspektimi i mëparshëm i kryer më datë 18.10.2018 në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë², për problemet e konstatuara i rekomanduam Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë dhe Drejtoreshës së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror marrjen e masave për:

1. Shtimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.
2. Bashkërendimin e punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksion të ngrohjes qendrore.
3. Ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
4. Shtimin e buxhetit për shtesë të një kati, me qëllim sistemimin në këtë institucion të të moshuarve të tjerë.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Bashkia Gjirokastrë ka informuar:

- *Për rekomandimin nr.1*, Bashkia Gjirokastrë do të planifikojë për vitin ushtrimor 2020, për të shtuar në organikën me një psikolog si dhe me një mjek me kohë të plotë.
- *Për rekomandimin nr.2*, Bashkia Gjirokastrë do të parashikojë që në buxhetin afatmesëm një qendër socio-sanitare ku do të trajtohen të moshuarit me probleme shëndetësore.

¹ "Akte ligjore për COVID-19" (Përditësuar datë 29.10.2021 FZ Nr. 168)

<https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>

² Rekomandimi i institucionit të Avokatit të Popullit dërguar me nr. K1/I56-2 prot., datë 15.02.2019.

- *Për rekomandimin nr.3*, Bashkia Gjirokastrë do të parashikojë në Buxhetin afatmesëm një qendër socio-sanitare ku do të trajtohen të moshuarit me probleme shëndetësore.
- *Për rekomandimin nr.4*, sipas PPV-së së Bashkisë Gjirokastrë lejohet shtesë kati për objektin Shtëpia e të Moshuarve, megjithëse nga ana e qëndrueshmërisë nëse objekti përmban shtesë kati, kjo zgjidhet nga hartuesit e projektit në momentin që do të gjenden fondet për buxhetimin e një projekti të tillë.

Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme³ ia adreson Bashkisë Gjirokastrë duke qenë se Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë është në varësinë e kësaj Bashkie.

Nga informacioni, rezultoi se nuk kishte gjetur zbatim asnjë nga rekomandimet e Avokatit të Popullit të lëna në inspektimin e mëparshëm:

1. Nuk ishin marrë masa për shtimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.
2. Nuk ishin marrë masa për bashkërendimin e punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksion të ngrohjes qendrore.
3. Nuk ishin marrë masa për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
4. Nuk ishin marrë masa për shtimin e buxhetit për shtesë të një kati, me qëllim sistemimin në këtë institucion të të moshuarve të tjerë.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit

Në këtë qendër strehohen të moshuar duke filluar që nga moshë 60 vjeç, por ka dhe përfitues të tjerë, të cilët vijnë si raste emergjente. Aktualisht strehoheshin 51 të moshuar ndërkohë që kapaciteti i kësaj qendre është prej 55 personash. 10 të moshuar janë të sëmurë me probleme të rënda shëndetësore, prapambetje mendore, të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë. Numri i personave të cilët përfitojnë pension pleqërie është 33, nga i cili 60% ju jepet vetë personave ndërkohë që 40% shkon në buxhetin e shtetit⁴.

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 21 punonjës, ku të gjithë ishin të kualifikuar sipas pozicionit përkatës. Vlerësimi i punës bëhet një herë në vit.

Dosjet personale të punonjësve të kësaj qendre mbahen në institucion. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë, e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Gjirokastrë.

³ Shkresa me nr. 387/1 prot., datë 11.03.2019 e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

⁴ Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr.898, datë 10.11.2010, "Për disa ndryshime në Vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror"

Drejtuesi i këtij institucioni u shpreh se stafi është i trajnuar dhe janë të pajisur dhe me certifikatat përkatëse. Stafi ishte i trajnuar rishtazi për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit. Ishin vendosur shkallët e emergjencës.

Shërbimet mjekësore realizohen nga mjeku, i cili punon me kohë të pjesshme. Spitali Rajonal Gjirokastrë herë pas here dërgon mjekë për të parë gjendjen shëndetësore të të moshuarve, sipas një akt-marrëveshje. Ndërkohë që me problemet psiko-sociale merret vetëm një punonjëse sociale

Shërbimi dentar realizohet me shpenzimet e të moshuarve, por edhe nga institucioni.

Ka një plan individual për çdo të moshuar dhe secili ka kartelën e tij mjekësore. Medikamentet që marrin të moshuarit pasqyrohen në një bllok të veçantë, i cili sekretohet dhe ruhet në arshivë.

Janë 35 të sëmurë kronikë. Barnat e rimbursueshme janë të pasqyruara në kartelë, ndërsa ato të parimbursueshme i mbulon vetë institucioni sipas rekomandimit të mjekut.

Kuota ushqimore ishte në vlerën 360 lekë në ditë për çdo person që trajtohet në qendër, e mjaftueshme për përfituesit.

Menyja javore përcaktohet nga të moshuar, kujdestarë, punonjësja sociale, mjeku dhe kuzhinierja, sipas mendimit të të moshuarve.

Në ambientet e brendshme dhe të jashtme të këtij institucioni mbizotëron pastërtia, gjë që tregon për një bashkërendim të punës së Drejtuesit, stafit dhe përfituesve.

Ishte kryer rikonstrukcion i përgjithshëm i çatisë, mirëpo kjo ndërhyrje nuk ishte e mjaftueshme për eliminimin e lagështisë në ambientet e institucionit. Për lagështirën ishte vetë institucioni që ndërhynte herë pas here me fondet e tij.

Të moshuarit për higjienën e tyre personale bënin dush dy herë në javë.

Në çdo kat, në ambiente të veçanta ishin të afishuara rregullorja e brendshme, standardet që duhet të respektonin punonjësit e qendrës dhe të përfituesve.

Kutia e ankesave, çelësi i së cilës mbahet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë, hapet në datë 1 (një) të çdo muaji, në prani të Drejtorit të institucionit dhe punonjësit social.

Furnizimi me artikuj hotelerikë gjatë vitit 2021 ka qenë sipas nevojave.

Aktivitetet me persona nga jashtë ishin kufizuar për shkak të pandemisë, megjithatë organizoheshin takime, biseda dhe lexime ndërmjet të moshuarve dhe personelit të institucionit.

Monitorimi i standardeve për përfituesit kryhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, të cilët e kishin monitoruar institucionin në dhjetor 2020 dhe qershor 2021.

Nga intervistimi që patëm me të moshuarit ata ishin shumë të kënaqur nga shërbimi i gjithë stafit të këtij institucioni. Shumica e të moshuarve kanë vite që jetojnë në këtë institucion dhe ndihen si në shtëpinë e tyre.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan edhe problematikat e mëposhtme:

- Janë 10 të moshuar me probleme të rënda shëndetësore, prapambetje mendore, gjë që krijon shumë shqetësim e të moshuarit e tjerë.
- Në organikën e punonjësve të institucionit nuk ka psikolog, i domosdoshëm të jetë i pranishëm për këto kategori përfituesish.
- Mbetet problematike rreziku për jetën e të moshuarve që mund të vijë nga ngrohja me rezistenca është evident, pasi mund të ndodhin avari në sistemin elektrik apo mund të mos fiken në mbrëmje.
- Një problem që vijon të mbetet shqetësues është edhe ai i mjekut me kohë të pjesshme, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë çdo ditë i pranishëm në qendër, të paktën 8 orë.
- Ka shumë kërkesa për sistemimin në këtë institucion, por kapaciteti është i pamjaftueshëm.

Për sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare për eliminimin e lagështirës në ambientet e institucionit.
3. Marrjen e masave për bashkërendimin e punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksion të ngrohjes qendrore.
4. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
5. Marrjen e masave për shtimin e buxhetit për shtesë të një kati, me qëllim sistemimin në këtë institucion të të moshuarve të tjerë.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Ermonela XHAFJA

Konc. & Dak.:
G.Çarkaxhiu
L.Xhillari